



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:123321  
Datë: 30.05.2024  
Numri i dokumentit: 05758702

**PA1.nr.745/24**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**, Departamenti i Përgjithshëm - në kolegjin penal të përbërë nga gjyqtarët Abdullah Ahmeti - kryetar i kolegjit, Skender Çoçaj dhe Ferit Osmani-anëtarë të kolegjit, me pjesëmarrjen e praktikantit gjyqësor Visar Gashi, në çështjen penale të akuzuarit XH.S nga fshati G e E, Komuna Lipjan, për shkak të veprës penale, Mbikëqyrje e pandërgjegjshme e trafikut publik, nga neni 381 par.3, lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së, duke vendosur përkitazi me ankesën e Prokuroria Themelore në Prishtinë, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë- Dega në Lipjan Departamenti Përgjithshëm Divizioni Penal, P.nr.377/23, datë 04.03.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 29.05.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

I. Me rastin e ankesës së Prokuroria Themelore në Prishtinë, e sipas detyrës zyrtare, **NDRYSHOHET** aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë- Dega në Lipjan Departamenti Përgjithshëm Divizioni Penal P.nr.377/23, datë 04.03.2024, ashtu që Gjykata e Apelit në bazë të nenit 362 par.1 nënpar.1.3 të KPRK-së ndaj të pandehurit XH.S,

**REFUZOHET AKUZA**

Se me datën 28.01.2017, rreth ores 23:15, në rrugën "Prizenit" në Lipjan, derisa i pandehuri M.G, e drejtonte automjetin e tipit Mercedes 201 me ngjyrë të zezë me targa 01-670-AP më saktësisht te udhëkryqi i semaforëve në Lipjan, në atë mënyrë që ka vepruar në kundërshtim me nenin 53 të LSKRR, nuk e ka përshtatur shpejtësinë e lëvizjes së automjetit ndaj kushteve të krijuara në komunikacion, rrugës së rrëshqitshme ashtu që duke dashur që t'i

shmanget një pengese të palëvizshme, një pusete në rrugë, të cilën kompania "Xhema com" me pronar XH.S, e kishte vendosur në kundërshtim me nenin 11 të LSKRR, duke mos vendosur shenja përkatëse të sinjalizimit për punimet në rrugë, dhe si pasojë automjeti e godet shtyllën e semaforit, me ç'rast pos dëmeve materiale, lëndime të lehta trupore kishte pësuar pasagjeri Rrahmon Gashi, kurse lëndime të rënda trupore kishte pësuar i pandehuri M.G.

-Me këtë kishte për të kryer veprën penale Mbikëqyrje e pandërgjegjshme e trafikut publik, nga neni 381 par.3, lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së.

**- Për shkak të parashkrimit absolut të ndjekjes penale për këtë vepër penale.**

II. Shpenzimet e procedurës penale bien në barrën e mjeteve buxhetore të gjykatës.

III. Lidhur me kërkesën pasurore - juridike të palës së dëmtuar, aktgjykimi i ankimuar ngel i pandryshuar.

### A r s y e t i m

Gjykatës Themelore në Prishtinë- Dega në Lipjan Departamenti Përgjithshëm Divizioni Penal me aktgjykimin P.nr.377/23, datë 04.03.2024, të pandehurin XH.S, konform nenit 363 par 1 nen par 1.3 të KPP-së e ka liruar nga akuza meqë nuk është provuar se ka kryer veprën penale Mbikëqyrje e pandërgjegjshme e trafikut publik, nga neni 381 par.3, lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së, pasi që nuk është provuar se i njëjti ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

Të dëmtuarit: M.G dhe RR.G, me vendbanim në H, Komuna Prishtinë, për realizimin e kërkesës pasurore juridike, udhëzohen në kontest juridiko – civil.

Shpenzimet e procedurës gjyqësore bien në barrë te mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ankesë ka ushtruar Prokuroria Themelore në Prishtinë, për shkak të vertetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktlike, me propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës ankesën ta aprovoj si të bazuar, ta anuloj aktgjykimin e atakuar dhe çështjen ta kthej në rigjykim dhe rivendosje.

Prokurori i Apelit në Prishtinë me parashtresën PPA/II.nr.747/2024, datë 20.05.2024 ka propozuar që të aprovohet si e bazuar ankesa e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, ashtu që aktgjykimi i ankimuar të anulohet dhe çështja ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje.

Gjykata e Apelit e Kosovës në Prishtinë mbajti seancën e kolegjit, shqyrtoj shkresat e lëndës, vlerësoj aktgjykimin e kundërshtuar në kuptim të nenit 394 të KPP, dhe pas vlerësimit të pretendimeve në ankesë, e sipas detyrës zyrtare gjeti se:

**- Në këtë çështje penale ka ardhur deri të parashkrimi absolut i ndjekjes penale**

Duke shqyrtuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë pas pretendimeve ankimore të lart cekura, e sipas detyrës zyrtare, konform dispozitës së nenit 394 të KPPRK-së, Gjykata e Apelit vlerëson se në rastin konkret ka ardhur deri te parashkrimi absolut i ndjekjes penale.

Gjykata e Apelit, sa i përket veprës penale e cila i vihet në barrë të akuzuarit me anë të aktit akuzues, gjen se sipas përshkrimit faktik të akuzës rezulton se i pandehuri Xhemshir Sejdiu akuzohet se “ me datën 28.01.2017, rreth ores 23:15, në rrugën "Prizenit" në Lipjan, derisa i pandehuri M.G, e drejtonte automjetin e tipit Mercedes 201 me ngjyrë të zezë me targa 01-670-AP më saktësisht te udhëkryqi i semaforëve në Lipjan, në atë mënyrë që ka vepruar në kundërshtim me nenin 53 të LSKRR, nuk e ka përshtatur shpejtësinë e lëvizjes së automjetit ndaj kushteve të krijuara në komunikacion, rrugës së rrëshqitshme ashtu që duke dashur që t'i shmanget një pengese të palëvizshme, një pusete në rrugë, të cilën kompania "Xhema com" me pronar XH.S, e kishte vendosur në kundërshtim me nenin 11 të LSKRR, duke mos vendosur shenja përkatëse të sinjalizimit për punimet në rrugë, dhe si pasojë automjeti e godet shtyllën e semaforit, me ç'rast pos dëmeve materiale, lëndime të lehta trupore kishte pësuar pasagjeri RR.G, kurse lëndime të rënda trupore kishte pësuar i pandehuri M.G”

Nga përshkrimi faktik sipas akuzës rezulton se i pandehuri dyshohet se ka kryer veprën penale me datën 28.01.2017.

Gjykata e Apelit konstatoi se dispozitat e nenit 3 par. 1 të KPRK e që kanë të bëjnë me zbatimin e ligjit më të favorshëm përcakton se: *ndaj kryesit zbatohet ligji që ka qenë në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale.* ndërsa par 2. i këti neni përcakton: *Në rast se ligji në fuqi ndryshon para shqiptimit të vendimit të formës së prerë, atëherë ndaj kryesit zbatohet ligji që është më i favorshëm,* pra në rastin konkret duhet të zbatohen ligji që ka qenë në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale.

Gjykata e Apelit konstatoi se për veprën penale Mbikëqyrje e pandërgjegjshme e trafikut publik, nga neni 381 par.3, lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së parashihet dënimi me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet.

Sipas dispozitës së nenit 106 par.1 nënpar.1.5 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës Nr.04/L-082, ndjekja penale nuk mund të ndërmerret nëse kanë kaluar 3 vite nga kryerja e veprës penale të dënueshme me më shumë se 1 (vit) burgim.

Ndërsa sipas nenit 107 par.8 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës Nr.04/L-082, ndjekja penale ndalohet në çdo rast kur të ketë kaluar dyfishi i kohës së afatit të parashkrimit.

Andaj marrë parasysh kohën në të cilën akuzohet se i pandehuri ka ndërmarrë veprimin e kryerjes së veprës penale, kanë kaluar më shumë se (gjashtë) vite, e që në rastin konkret ka kaluar dyfishi i kohës së parashkrimit, gjegjësisht më datë 28.01.2023 ka arrit afati për parashkrim absolut për këtë vepër penale.

Andaj, duke u bazuar në këto dispozita ligjore në njëren anë, ndërsa në anën tjetër duke pasur parasysh kohën kur dyshohet se është kryer vepra penale, si dhe dënimin e parashikuar për

këtë vepër penale, kolegji penal i Gjykatës së Apelit të Kosovës konstaton se në rastin konkret kanë kaluar më tepër se 6 (gjashtë) vjet nga koha kur dyshohet se është kryer kjo vepër penale, kohë kjo që shpie në parashkrimin absolut të ndjekjes penale. Në këtë mënyrë, duke u bazuar në të lartcekurat dhe në nenin 362, paragrafi 1 nën-paragrafi 1.3. të KPPRK, kolegji penal i Gjykatës së Apelit të Kosovës, e ka ndryshuar aktgjykimin e ankimuar, duke e refuzuar akuzën ndaj të akuzuarit, për shkak të kalimit të dyfishit të afatit të parashkrimit të ndjekjes penale (parashkrimi absolut i ndjekjes penale).

Shpenzimet e procedurës penale do të paguhen nga mjetet buxhetore të gjykatës.

Duke u bazuar në këto që u thanë më lart e në bazë të nenit 398, paragrafi 1. nën-paragrafi 1.4. të KPPRK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**  
**Departamenti i Përgjithshëm**  
PA1.nr.745/24, më datë 29.05.2024

**Procesmbajtës**

**Anëtarët e kolegjit:**

**Kryetar kolegjit**

Visar Gashi

Skender Çoçaj

Abdullah Ahmeti

Ferit Osmani